



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 13 janar 2022, në mbledhjen e I-rë (parë) – e jashtëzakonshme mandati VII, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr.52, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 13;30

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Naim Çunaku, Qëndrim Softolli, Arnisa Sylejmani, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Sebastina Vokri, Bashkim Sylja dhe Mrika Thaqi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe; Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, theksoi, meqë të gjithë anëtarët e këtij komiteti janë prezent dhe ekziston kuorumi mund të vazhdojmë me punë, për këtë mbledhje janë paraparë 2 pika të rendit të ditës, njëra është me propozimin e Kryetarit të Komunës z.Shpejtim Bulliqi kurse tjetra është me propozimin tim si Kryesuesit të Kuvendit.

Pika e parë siç e dini është një prej më të rëndësishmeve të Kuvendit të Komunës dhe KPF-së, ky buxhet dihet që është dashur të miratohet vitin e kaluar nga Kuvendi i kaluar komunal mirëpo për shkak të mungesës së votave nuk është miratuar dhe tani sërish si përbërje e re e KPF-së dhe e Kuvendit e kemi për shqyrtim dhe miratim. Rendi i ditës nuk mund të ndryshoj sepse është mbledhje e jashtëzakonshme, mirëpo urdhëroni nëse ndokush diçka të shtoj në lidhje me këtë para se ta merre fjalën drejtori i DBF-së.

z.Naium Çunaku, theksoi, seanca e thirrur për nesër gjegjësisht me datën 14.01.2022 për mua është në kundërshtim me Rregulloren, Statutin dhe me Ligjin për vetëqeverisje lokale, arsyeja pse, i nderuar Kryesues për një mbledhje dihet dhe është e rregulluar me Rregullore se si shpërndahet materiali për anëtarët e Kuvendit, dhe ta vendosësh përpara dokumentin më crucial për një vit buxhetor dhe për një vit kalendarik të Komunës pa pasur material, unë që duhet të votoj dhe unë që duhet të shoh orientimin zhvillimor të Komunës dhe të përfaqësoj interesat e lokalitetit në Kuvend, pa material më duket se është një prej shkeljeve më të rënda që keni mund ta bëni ju si Kryesues me gjithë stafin e juaj dhe për këtë mendoj që nuk ka kushte për të marr vendim për buxhetin.

Pas kësaj dua edhe një sqarim nga drejtori i DBF-së nëse është e përcaktuar me afate ligjore që e kemi pasur aq ngushtë, natyrisht pa fajin ton sepse dihet kur miratohet një buxhet i rregullt e që ka qenë 30 shtatori i vitit të kaluar, pa dashur të hyjmë në arsye se pse dhe kush e ka fajin për sjelljen në këtë situatë e gjithë kjo ishte për arsyetim të paktën para qytetarëve sepse nuk guxoj të i jap vetës të drejtë që t'i cungoj projektet e tyre edhe nëse i kemi ngushtë afatet.

Edhe mund të mbyllen sytë dhe për interes të qytetarëve dhe për interes të realizimit të projekteve që janë të parapara në atë buxhet mund të diskutojmë, por forma e tillë që unë si këshilltar i Kuvendit të

mos e kam materialin të cilin duhet ta shoh se ku janë orientuar ato planifikimet, për mua është e pa tolerueshme dhe zotëri Kryesues kjo të jetë e fundit, përndryshe e ke të drejtën dhe mund të vazhdosësh kështu, por duhet nëse vazhdon kjo praktikë ne do të shfrytëzojmë edhe mekanizmat tonë ligjor dhe statutar edhe si përfaqësues në Kuvend mund ta shqyrtojmë, por nuk do të doja ta marrim epitetin e atyre që bojkotojnë diçka që është në interes të qytetarit. Kur e ke dhënë betimin si Kryesues ke premtuar që do të jesh Kryesues i të gjithëve, dhe parimore e juaja është që të kujdesesh t'iu krijosh kushte këshilltarëve që me qenë në nivelin për atë çka jemi.

Zotëri Kryesues, ju jeni një prej të barabartëve prej nesh dhe nuk kisha dashur që të shoh ndryshe sepse për atë edhe je, por fundja ju e dini prap.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ne jemi legjislativë e re, por çka kam kuptuar përmes zyrës ligjore, në të kaluarën është praktikuar që materiali këshilltarëve u është dërguar përmes emailëve, kështu që shumica kanë pasur pajisjet nëpër shtëpitë e tyre, mirëpo ne çka jemi këshilltarë të zgjedhur të ri në na mungojnë lloptopët, unë kam biseduar edhe me zyrën ligjore edhe me stafin teknik që merret me këtë çështje ata më kanë informuar që shumë shpejt do t'i pajisim me lloptopë anëtarët e Kuvendit mirëpo vetëm derisa t'i kthejnë ata që kanë qenë anëtar të Kuvendit në mandatin e kaluar, por sërish unë e kam përcjellë kërkesën e disa prej anëtarëve të Kuvendit që t'ju dërgohen materialet edhe fizikisht dhe ju janë përgatitur material dhe ju është dërguar e-maili që duke ju ftuar që kush do që dëshiron ta marr fizikisht materialin mund të vije në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit dhe ta marr, mirëpo ndoshta edhe mund të jetë gabim që nuk ua kemi dërguar në shtëpi.

z.Naim Çunaku, theksoi, sa i përket praktikave që janë zhvilluar në këtë Kuvend, ndoshta jeni në dijeni ndoshta jo, por unë jam këshilltar prej vitit 2000 dhe për praktikën e këtij Kuvendi i jap vetës të drejtë të them se i di më së miri se si kanë shkuar, nuk ka praktikë për diçka që është e rregulluar me Statut me Ligj dhe me Rregulloren të Punës së Kuvendit, pra për ne praktikë është ligji, praktikë është Statuti.

Unë fola në vetën e parë, thashë se unë nuk e kam pasur materialin, nëse dikush mendon se e ka kryer punën dhe nëse në email-in tim në telefon ka ardhur projekt buxheti i Komunës, për mua është më tepër se shaka. Jemi në mbledhjen e KPF-së dhe këtë mbledhje e udhëheq Kryesuesi i Kuvendit njëherit edhe Kryesuesi i KPF-së dhe forma se si ajo e udhëheq është e tij. Ne para se të hyjmë në diskutime e tha edhe Kryesuesi dhe e dimë të gjithë që të gjithë këtu se nuk mund të ndryshohet apo plotësohet rendi i ditës, është ana formale që duhet të përbushet por para se të kalojmë në rend dite ishte vërejtje rreth përgatitjes së mbledhjes.

z.Bashkim Sylaj, theksoi, pa dashur të përfshihem në këtë debat, vetëm po e tregoj një praktikë për 4 vite që jam asamblist nga mandati i kaluar, dua të them se materiali na është dërguar në email-e dhe pse lloptopët në fillim nuk na janë shpërndarë për afër 1 vit e gjysmë, kështu që ne përmes email-ëve i kemi pranuar, i kemi shtypur dhe jemi përgatitur dhe kështu kemi vazhduar. Pra kjo ka qenë praktika të cilën e kemi zhvilluar në të kaluarën, ndërsa tani ndoshta është edhe fillimi, por kjo nuk do të thotë që nuk mund të ndryshohet, mirëpo është mirë që në mbledhjet e ardhshme të vazhdohet ashtu siç është e rregulluar me ligj.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka diskutime tjera rreth rendit të ditës, tani e hedh në votim rendin e ditës, kush është që të punohet me këtë rend dite sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

Njëzëri miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje dhe materialit përkatës të dërguar.

1. Propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023-2024

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, lidhur me këtë pikë jeni të informuar të gjithë që afati kohore për aprovimin e këtij buxheti ka qenë fundi i shtatorit të vitit paraprak kur do të duhej të miratohej buxheti për vitin 2022, por dihet qysh është zhvilluar situata dhe pastaj nuk ka kaluar dhe rrjedhimisht kemi kaluar tek zgjedhjet lokale, dhe tani me përfundimin e zgjedhjeve lokale deri në konstituimin e asamblesë pa zgjedhjen e Kryesuesit dhe organeve tjera të asamblesë komunale nuk kemi mund të shkojmë me propozimin e buxhetit. Normalisht në bazë të procedurave të cilat koordinohen nga zyra ligjore në bashkëpunim me Kryesuesin e Kuvendit për materiale të Kuvendit si Drejtori e Buxhetit dhe Financave i kemi përcjellur të hënën tek Kryesuesi dhe zyra ligjore e cila normalisht se është e detyruar t'i përcjell tek të gjithë asamblistët e Kuvendit.

Ky buxhet edhe pse ka kaluar të gjitha procedurat publike që janë paraprake edhe me Kornizën Afatmesme Buxhetore ku vetëm për buxhetin 2022 bashkëpunimin që e kemi pasur dhe ftesën të cilën ia kam bërë të gjitha Grupeve të asamblistëve për bashkëpunim rreth planifikimit të këtij buxheti mirëpo tani jemi në situatën kur jemi pa buxhet dhe kemi filluar në vitin 2022 pa buxhet, diçka që tani ne në muajt janar-shkurt-mars mund të operojmë me 1/12 të buxhetit të vitit paraprak, mirëpo kjo e ka edhe problemin tjetër që pa aprovimin e buxhetit ne nuk mund ta aprovojmë planin e prokurimit dhe kjo i shkakton një ngecje tjetër Komunës së Podujevës sepse nuk mund të procedohen projektet kapitale të drejtorive për në Prokurim e që janari dhe shkurti janë muajt ku duhet të procedohen projektet sepse dihet që është një afat kohor pastaj edhe për zyrat e prokurimit, prandaj mos realizimi i tyre me kohë dërgon edhe tek suficitet buxhetore, dhe kjo është ajo që na ka munguar në parim.

Pajtohem që buxheti nuk është mirë të shqyrtohet në seancë të jashtëzakonshme, mirëpo arsyet pse jemi në një seancë të tillë janë rrethanat dhe ecuria komplet siç ka qenë e zakonshme, na ka sjell në këtë pikë që ne duhet të shkojmë në seancë të jashtëzakonshme, ta shqyrtojmë dhe ta miratojmë para se të shkoj në ministrinë e Financave për aprovim edhe nga ana e tyre.

Pra ky buxhet që tani është në Word dhe në Excel duhet të hyjë në E-sistemin që është programi DBMS dhe Ministria e Financave nuk e lejon qasjen pa u aprovuar buxheti në asamblenë komunale, pastaj pas këtij aprovimi të buxhetit në asamblenë komunale normalisht një periudhë kohore e merr edhe inkuadrimin në sistem. Mandej komplet dokumentacion dërgohet në Ministrinë e Financave e cila pastaj në këtë situatë që jemi ne projektbuxheti i miratuar dërgohet për miratim në Parlamentin e Kosovës, pra jemi Komuna e Podujevës edhe 6 komuna të tjera të cilët nuk e kanë aprovuar me kohë buxhetin dhe për të gjitha këto duhet të shkoj si anex buxhet për aprovim në Parlamentin e Kosovës.

Normalisht që mund të kemi probleme në afate kohore, për çka nga shumë njerëz më kanë pyetur lidhur me problemet që mund t'i kemi nga mos aprovimi i buxhetit me kohë, por normalisht për muajt janar dhe shkurt posaçërisht në kategorinë e pagave dhe të mallrave nuk kemi probleme sepse na mundësohet me 1/12-tën e buxhetit, mirëpo pas kësaj mund t'i kemi këto dhe probleme tjera.

Ky buxhet i ka kaluar të gjitha procedurat të cilat parashihen me ligj, siç janë dëgjimet publike me qytetar, pastaj është dërguar në asamblenë e kaluar Komunale pasi që ka kaluar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, mirëpo në mbledhjen e asamblesë komunale nuk i ka marr votat e mjaftueshme për aprovim, buxhet i cili është përgatitur në bazë të limiteve buxhetore të parapara me Qarkoreve Buxhetore të Ministrisë së Financave, Qarkore në bazë të të cilave edhe është hartuar planifikimi buxhetor e që limit i përgjithshëm është 23,449,521€ i përcaktuar nga Ministria e Financave normalisht në bazë të projeksioneve të tyre për buxhetin e Komunës së Podujevës si dhe limitet tjera të përcaktuara me Qarkoren Buxhetore siç janë për grantin specifik për arsim, granti specifik për shëndetësi e të tjera

që ne si Komunë jemi të obliguar t'iu përmbahemi atyre limiteve. Tek granti specifik për shëndetësi kemi 3,370,000.00€ dhe i'u kemi përmbajtur në përpikëri, mirëpo tek granti specifik për arsim është tejkaluar sepse në bazë të Ligjit për Financa Publike kemi të drejtë që në fondin buxhetor për arsim të shtojmë mjete nga granti i përgjithshëm dhe nga të hyrat vetanake, pra kemi rritje të theksuar të buxhetit për arsim që ka shkuar nga granti i përgjithshëm ku ndoshta vetëm në pozicionet buxhetore për renovimin e objekteve arsimore thuajse kemi 5-fishim të buxhetit por që normalisht buxheti i Komunës së Podujevës nuk është 5-fishuar, mirëpo i është dhënë prioritet edhe sferës së arsimit dhe besoj që të gjithë ata të cilët kanë pasur materiale edhe që kanë mundur t'i shikojnë këto projekte, pos kësaj prioritet i është dhënë edhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik ku parashihet zona industriale, subvencionimi dhe norma e interesit për kredi prodhuese, subvencione për bizneset e vogla dhe të mesme dhe për grante kryesisht në bashkëpunim me donatorët.

Mandej kemi Kulturën që ndoshta për herë të parë thuajse bëhet pjesë e prioriteteve buxhetore ku parashihet ndërtimi i shtëpisë së kulturës për të cilën me të drejtë mund të pyes ndokush se a mjafton planifikimi i shumës prej 100,000.00€ për ndërtimin e shtëpisë së kulturës, unë e them se absolutisht nuk mjaftojnë ngase bëhet fjalë për shpronësime dhe çështje tjera përkatëse, por do të jetë një projekt në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Edhe në fushën e infrastrukturës publike e cila pa dyshim ende vazhdon ta ketë një pjesë të madhe të buxhetit dhe strukturës së investimeve kapitale, ka projekte bukur të mëdha siç është ndërtimi i rrugëve "Skënderbeu" dhe "Xhemajl Mustafa" dhe këtu ndokush me të drejtë mund të thotë se për një rrugë që ndoshta është mbi 3 km, nuk e di saktë a mjafton shuma prej rreth 700,000.00€ e që mendoj se nuk mjafton mirëpo edhe ky projekt është në bashkëpunim me Ministrinë e cila do të participoj me një pjesë të madhe të mjeteve buxhetore, mandej hapja e rrugës tek Xhamia e cila vazhdon deri tek magjistranja Podujevë-Prishtinë, si dhe shumë projekte tjera me të cilat nuk po dëshiroj t'ju marr kohë duke i cekur. Edhe për projekte dhe planifikime tjera, limitet buxhetore janë të përcaktuara edhe me Kornizën Buxhetore se sa do të shpenzohen në kategorie të caktuara buxhetore siç është kategoria e mallrave, kategoria e shpenzimeve kapitale, kategoria e subvencioneve e të tjera, sepse gjitha këto janë limite të përcaktuara sepse ndoshta me dëshirë do t'i rritshim po të kishim mundësi, posaçërisht kategorinë e subvencioneve sepse ka pasur propozime të ndryshme qoftë prej asamblistëve por edhe prej grupeve të qytetarëve dhe më gjerë, për subvencionimin e grupeve të caktuara shoqërore, mirëpo limiti buxhetor i subvencioneve është 960,000,00€, faktikisht ka pasur kërkesë edhe prej bujqve që të rriten subvencionet në bujqësi por sërish po e përsërisë që nuk na është dhënë mundësia me limite buxhetore që përcaktohet me Qarkore Buxhetore edhe pse ka rritje për afër 200.000.00€ prej vitit të kaluar tek subvencionet, ka dyfishim të bursave për student ku prej 50,000 janë bërë 100,000,00€, pastaj për herë të parë janë planifikuar për subvencione për biznese, mandej mjete për subvencionimin e kredive prodhuese ku ideja është të ketë një lidhje në mes zonës industriale dhe mbështetjes direkte që e bëjmë në mënyrë që të stimulohet prodhimi, pastaj limitet buxhetore kemi në shumë 2,650,000.00€ kemi edhe në kategorinë për mallra, dhe komplet këto limite janë të përcaktuara me Qarkore Buxhetore.

Pra këto janë disa prej çështjeve që deshta t'i them, por sigurisht për projektbuxhetin do të debatohet edhe në mbledhjen e asamblesë komunale, mirëpo për çfarëdo që i'u intereson rreth kësaj pike jam i gatshëm të bisedojmë, të jap sqarime dhe t'iu përgjigjem pyetjeve të juaja.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, sa i përket rëndësisë së projektbuxhetit thuajse e dimë të gjithë që është dokumenti më i rëndësishëm që kalon përmes Kuvendit të Komunës, po ashtu e dimë rëndësinë e pagave por edhe projekteve që janë me rëndësi të veçantë për qytetarët dhe Komunën.

Ky dokument është identik me atë të kaluarin të cilën na sollët herën e kaluar në muajin shtator e që sa i përket diskutimeve dhe vërejtjeve i keni marr të gjitha në atë kohë në mbledhjen e Kuvendit, madje ka pasur edhe brenda Grupit të LVV-së vërejtje jo vetëm nga subjektet tjera por nuk kam parë ndonjë

ndryshim. Vend për vërejtje dhe kritika ka gjithmonë por nuk është as afër të duhurit si projektbuxhet dhe po të hyjmë në detaje rreth kodeve dhe emërtimeve të projekteve duket jo shumë serioze kur shohim se ndahen rreth 288,000.00€ për asfaltim të asaj rruge dhe rrugicave nëpër lagje, pra gjithëpërfshirës dhe jo serioze sepse mundet pastaj të bëhet një lloj selektimi, e që do të duhej të kishte ndonjë emërtim më specifik, për çka keni kritikuar vazhdimisht, nuk po flasim për qeverisjen e kaluar sepse keni qenë prezent dhe jeni në dijeni për mendimin tim.

LDK nuk e përkrah këtë projektbuxhet, nuk na keni ofruar bashkëpunim, nuk na keni thirr, nuk e kemi diskutuar me ne, pavarësisht asaj që e cekta se për këtë projektbuxhet kemi diskutuar në Kuvend dhe kemi jap vërejtje dhe tani çfarë është ndryshuar në këtë dokument prej të kaluarës e që sa unë kam arritur të shohë është thujse identik me atë të kaluarin, andaj ne nuk e përkrahim. Sa i përket detajeve tjera mund të diskutojmë edhe në Kuvend rreth pikave të caktuara.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, padyshim ky buxhet është i njëjti me disa ndryshime të vogla të cilat kanë ndodh prej atyre që i kanë propozuar, disa ndryshime të cilat kanë ardhur në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, pra pak a shumë disa ndryshime teknike dhe ato mund t'i gjeni tek Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ku edhe aty mendohet të kenë disa marrëveshje partneriteti për ndërtimin e disa objekteve shëndetësore. Pa dyshim që është thujse buxheti i njëjtë sepse ne kemi të njëjtat Qarkore Buxhetore çfarë kanë qenë.

Ky buxhet i ka kaluar të gjitha dëgjimet publike dhe si qeveri në mandatin e kaluar që ishte mandat i shkurtër rreth 1 vjeçar kemi qenë shumë të hapur në bashkëpunim me të gjithë duke përfshirë edhe qytetarët sepse e kemi obligim dhe për interes të qytetarëve jemi, mirëpo edhe nga subjektet politike ne kemi kërkuar dhe ofruar bashkëpunim, LDK-ja në mandatin e kaluar të asamblesë i ka pasur 15-16 asamblistë dhe normalisht që është e pa kuptimtë të thërrasim ta zëmë çdo asamblistë të tyre e që në një mënyrë i bije edhe mos respektim të vet LDK-së, por ne i kemi ftuar shefin e Grupit të asamblistëve që ka qenë z.Hasan Ajeti të cilin pra e kemi ftuar për bashkëpunim i kemi thënë kur të duash qoftë në zyrën e Drejtorisë së Financave qoftë tek Kryetari i Komunës që i kemi ftuar edhe të tjerët por nuk ka ardhur, tani është e pa kuptimtë në qoftë se nuk vije shefi i Grupit të asamblistëve por ai do të mund ta delegonte dikë tjetër mirëpo në qoftë se nuk vije ai ne nuk mund ta thërrasim pastaj z.Qëndrim Softollin pa marr parasysh që ne këtu të gjithë njihemi, pra nga ne është rrespektim i institucionit në këtë rast të LDK-së. Sigurisht që çdo buxhet gjithmonë është i debatueshëm, madje edhe me vetveten sepse ndoshta po ta shikojmë sërish tani sigurisht që ndonjë projekt tjetër e priorizon pak më shumë se një tjetër apo diçka të ngjashme, mirëpo ndihem mirë që është më i mirë se buxheti i vitit 2021 dhe këtë e them sepse të gjithë besoj pajtohemi me prioritetet që i ka kjo Komunë dhe ky vend, të gjithë pajtohemi se arsimit është prioritet dhe çfarë do të bëjmë për arsimin si prioritet me këtë buxhet.

Kur është fjala për buxhet mund të themi se buxheti tregon prioritet apo dashni (po shprehem kështu) për një sektor, për aq sa ndahet buxhet më shumë për të, në qoftë se tani kemi rritje afër 5 fishim në pozicionin buxhetor për renovimin e institucioneve arsimore sepse kudo që punojmë ne që nuk jemi direkt i njohim thujse mirë problematikën siç është rasti i shkollave që tani mund të themi se janë në gjendje të kënaqshme, më parë nëse keni mund t'i shihni janë ndarë zakonisht 116,000.00€-119,000.00€ për renovimin e institucioneve arsimore në institucionet parashkollore dhe ajo ka ndodh për shkak se kanë qenë limite buxhetore të asaj kohe të cilat caktohen me Qarkore Buxhetore, pra të mos ishte ai limit ndoshta do të ishte ndarë shumë më e vogël buxhetore, mirëpo ne e kemi 5 fishuar në raport me atë që e përcakton Qarkorja Buxhetore, shembull tek granti specifik për arsim specifikohet shuma për kategorinë e pagave dhe aty nuk mund të rritet buxheti sepse është numri i punëtorëve dhe përcaktohet limiti, ndërsa sa në kategorinë e mallrave dhe atë të investimeve kapitale për arsim, kemi pasë limitin 190,000.00€ kurse ne i kemi dërguar 530,000.00€, pra në të kaluarën është marrë parasysh gjithmonë limiti buxhetor dhe nuk është konsideruar prioritet arsimit.

Në Shëndetësi ka jashtëzakonisht projekte të rëndësishme që ne edhe pajtohemi që duhet të jetë prioritet ndërtimi i Urgjencës që do jetë në bashkëpunim me Shoqatën nga Katari, pastaj ndërtimin dhe renovimin e objekteve tjera dhe pajisjet mjekësore që sot nuk lëvizin asgjë.

Edhe sa i përket Kulturës që besoj se duhet të jetë prioritet, ka qenë e anashkaluar thuajse dhe për këtë këtu prezent e kemi një ish drejtoresh të asaj Drejtorie, por buxheti për kulturë ka qenë më pak se qesharak në çdo periudhë kohore, ndërsa tani kemi një buxhet thuajse të lartë për çështje të kulturës, i kemi 350,000.00€ vetëm në investime kapitale, mandej për trashëgimin kulturore a është menduar ndonjëherë në këtë vend, unë e them se asnjëherë, dhe ka pasë projekte buxhetor të varfra por tani ka shumë projekte edhe Ministria e Kulturës për trashëgimin kulturore në Podujevë, disa objekte të trashëgimisë kulturore, terrenet sportive që janë fushat e sportit edhe ndërtimi i qendrës së kulturës, po ashtu edhe qendra rinore që do të jetë komplet financim prej Ministrisë së Kulturës që po thuajse për herë të parë nuk ka ndodhur për kulturë ashtu siç kemi edhe për arsim për herë të parë kaq fonde buxhetore, mandej edhe për shëndetësi ka fonde të mjaftueshme dhe gjithashtu për herë të parë edhe për ekonomi sepse Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik ka qenë aty vetëm për t'ia jap dikujt atë pozicion dhe ta bëjë drejtor që ta rehatoj, por fonde për atë Drejtori nuk ka pasur asnjëherë, madje për zonën industriale i vendosshin rreth 30,000.00€ për çdo vit dhe të njëjtat barteshin për diçka tjetër për t'i shpenzuar ato mjete, ndërsa tani ato 40 hektar së shpejti do të kthehen në zonë industriale, projekt për të cilin 200,000.00€ i ka ndarë Qeveria e Republikës së Kosovës, 200,000.00€ i kemi ndarë ne dhe do të ndahen ende më shumë, zona industriale do të bëhet.

Gjithashtu kemi edhe fonde për subvencionimin e kredive prodhuese, fonde për start-up si edhe projekte tjera madhore infrastrukturore siç është hapja e rrugëve të reja e që ndoshta për herë të parë Lumi Llap do të kthehet në boshtin kurrizor të këtij qyteti çfarë i takon atij lumi sepse Llapin e kemi pasur pas shpine gjithmonë, madje edhe kjo rruga që është bërë ka qenë faktikisht një devalvim i lumit Llap aty sepse është bllokuar lumi Llap ndërsa tani do të jetë rrugë besoj me një koncept tjetër.

Pastaj kemi edhe rregullimin e rrugës “Skëndërbeu” e cila lidhet me rrugën “Xhemajl Mustafa” që është rruga më e gjatë e qytetit, pastaj ka një gjithë përfshirje të fshatrave sa i përket investimeve edhe pse për disa fshatra dikush mund të thotë nuk janë të cekura në buxhetin e vitit 2022, por janë në vargun e punëve të vitit 2021. Kështu që ne jemi të lumtur që buxheti për vitin 2022 është pakëz më të mirë se ai i viteve 2021 dhe 2020, por sigurisht gjithëherë ka vend për debat dhe do të ketë, por ne kemi qenë shumë të hapur për këtë.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, desha të ndërhyjë pak vetëm tek thirrjet - ftesat në përbërjen e kaluar, tani jemi përbërje e re dhe si LDK kemi 14 asamblist, në përbërjen e kaluar i kemi pasur 15 apo 16, do të thotë është përbërje e re e Kuvendit dhe nuk keni shprehur gatishmëri për bashkëpunim me këtë përbërje, nëse ju nuk po na ofroni bashkëpunim ose nuk po na thirrni nënkupton se nuk po ju intereson vota jon për ta përkrah këtë projekt buxhet apo jo. Përderisa silleni në këtë mënyrë mos pritni prej nesh të gjejmë bashkëpunim ose konsensus. Pajtohem që në mandatin e kaluar e kemi thirr - ftuar z.Hasan Ajetin por tani nuk është më ai anëtar i këtij Kuvendi kurse subjekti politik është e njëjtë, unë po të kuptoj ty (i drejtohet drejtorit të DBF) por nuk mund të thirresh nonstop/vazhdimisht në atë.

Sa i përket orientimit që po krenoheni tani duke cekur vazhdimisht, më shumë buxhet në arsim, etj etj, por shumicën e projekteve thuajse i keni gjetur të gatshme sikurse projektet kapitale në urbanizëm dhe në infrastrukturë publike që i keni gjetur thuajse të përfunduara, po flas për projektet më të mëdha, ndërsa tani normale që hapësira është më e madhe që buxheti të orientohet edhe nëpër Drejtoritë tjera përkatëse që u përmendën deri më tani nga drejtori.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, prioritet besoj që ish dashur të jetë arsimi.
z.Qëndrim Softolli, përgjigje drejtorit të DBF-së, kishte dashtë me qenë por ju vet e theksuat.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF-së, përgjigje parafolësit, theksoi, jo nuk është ashtu sepse limitet buxhetore mund të rritën, pra fjala është limitet në arsim nga grantet e përgjithshme dhe të hyrat vetanake.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, jemi në dijeni pak a shumë se si shkon kërkesa e qytetarëve deri më tani.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, po ashtu është por nganjëherë qeverisja duhet që t'iu prijë disa gjërave.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, po edhe mentaliteti bëhet update, normale.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, dua të bëjë vetëm edhe një sqarim sa i përket emërtimeve të projekteve, e kemi thënë edhe herën e kaluar por edhe më herët kur unë nuk kam qenë as pjesë e qeverisjes as e asamblesë komunale, emërtimi i projektit në maksimum i ka 40 karaktere në program dhe këtë sërish po e përsëris sepse kjo është bazë në Excel, por ky emërtim pastaj duhet të jetë i njëjtë me atë në program sepse ky propozim kthehet në vendim, kështu që nuk mundemi të fusim më shumë karaktere, shembull, ndërtimi i rrugicave, rrugët kur të regjistrohen janë 40 rrugica.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, më fal i nderuar drejtor, nuk po diskutojmë për një shumë prej 30,000.00€, por janë në pyetje mjetet të ndara në shumë 277,000.00€.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, mendoj se sugjerimet bëhen në seancë të Kuvendit, kështu edhe besoj që u tejkalua kjo çështje.

z.Naim Çunaku, theksoi, me vëmendje e dëgjova drejtorin e DBF-së, e vërteta është se e kam ditur që deri në muajin mars është faza e fundit për miratimin e buxhetit të ri, për të mos hyrë në atë që kalohet pas muajit mars dhe kjo më interesoj dhe më japi të drejtën të them që e përjashton të drejtën e seancës së jashtëzakonshme sepse kemi pasur kohë.

Diçka çka më ra në sy, unë e kuptoj shumë mirë, Ekzekutivi i Komunës në Podujevës tani vetëm a është me partinë në pushtet LVV-në dhe koalicionin e bërë, apo të pa bërë, është krejt e juaja dhe nuk jam prej atyre që dua të them çështje të tilla dhe unë e di që politikat dhe programet i bëni ju dhe është në dorën e juaj sepse për atë jeni dhe e keni pushtetin, e jona si opozitë në këtë rast e që një gjë të tillë e ka vendos rezultati zgjedhor që në Kuvend nuk jemi opozitë por sipas vullnetit të qytetarëve jemi partia e parë, ne e pranojmë dhe e shohim të arsyeshme apo nuk e shohim të arsyeshme t'i japim vërejtjet e tona, nëse ka gatishmëri nga të gjithë asamblistëve tjerë që të na përkrahin në ato që ne i bëjmë jemi në rregull, nëse nuk na përkrah, vazhdohet me shumicën ashtu edhe siç bëhet kjo, dhe kjo është qeverisja. Nuk e kam atë telash që të kemi bashkëpunim me Kryesuesin e Kuvendit sepse është i të gjithëve dhe është diçka tjetër dhe për atë e kisha poentën tek Kryesuesi të cilin sigurisht që jeni në dijeni se e kam mik shumë të mirë por fundja për mua kjo seancë është e pa përgatitur dhe nuk më jep të drejtë por as unë nuk i jap të drejtë vetës specifikisht për diçka të tillë. Është hera e parë që jam në një mbledhje qoftë të komitetit apo të Kuvendit (dhe për këtë ka këtu dëshmitar që më njohin edhe më herët), që nuk di asgjë për çka të flasë, dhe kush ma ka cunuar këtë të drejtë që e kam me Statut, me Rregullore dhe me Ligj, për këtë e pata vërejtjen tek Kryesuesi kurse për çështjet tjera i debatoj në mbledhjen e Kuvendit.

Për ta përmbyllur, ajo çfarë më bëri përshtypje drejtori i DBF-së është ajo që e ceku se buxhetin në vitin 2021 e kemi përmirësuar, dhe në 2022 e kemi bërë edhe më të mirë projekt buxhetin, mirëpo i nderuar drejtor a mund ta shtyni edhe për rreth 1 muaj mos po bëhet edhe më i mirë ky projekt buxhet, këtë e them në kuptimin që mos ta aprovojmë edhe në këtë seancë, dhe krejt në fund, e thashë edhe në fillim të fjalisë se po ta di që nuk është cungim i projekteve që lehtësojnë jetën e qytetarit për realizim të projekteve dhe për të mirën e qytetarëve, edhe kishim mund ta mbyllim këtë gjë, ndërsa sot unë për vete të jeni të bindur edhe pa konsultim as të atij as këtij, unë nuk mund të jem pro për një diçka që nuk e di se çka po votoj, nuk mund të blej diçka në thes pa e parë se çka është, unë jam kundër që të shkoj tutje.

z.Bashkim Syla, theksoi, dua që shumë shkurt sepse vërtetë buxheti diskutohet, propozimet merren edhe në Kuvend, mirëpo unë desha të paktën të flas rreth këtyre specifikave të projekteve e që e kemi

kritikuar edhe LDK-në edhe LVV-në në seancat dhe mandatet e kaluara rreth specifikimit të projektit. Unë me ftesë të drejtorit të DBF-së e kam pasur një takim dhe e kemi diskutuar këtë çështje, një pjesë e projekteve janë të specifikuara kryesisht ato që janë më kryesore dhe më të mëdha, por arsyeja është e njëjtë siç e tha këtu edhe drejtori i DBF-së, pra edhe mua më ka thënë që vet rubrikat janë të tilla që nuk i zënë të gjitha specifikat e një projekti, shembull një rrugë dhe një fshat nuk mund t'i vendosin të gjithë, por vetëm ceken fshatrat edhe pse në disa raste e kam vërejtur që ndoshta kanë mundur edhe paksa diçka të ndahen tek sqarimet. Edhe tek disa fshatra që kanë mbetur të pa përfshira në projekte të infrastrukturës dhe aty sqarimi i drejtorit ishte që kur të rialokohen të hyrat vetanake ato projekte dhe ato fshatra do të jenë pjesë e rialokimit.

Gjithashtu jam interesuar edhe për Çerdhe dhe disa prioritete tjera, mirëpo më kanë thënë se do të sjellën si projekte nga Qeveria e Kosovës dhe janë 3 lokacione për Çerdhe për të cilat përgjigja ka qenë se janë në Qytetin e Podujevës, dhe në fshatrat Kërpimeh dhe Gllmanik, lokacione për të cilat Drejtoria do t'i caktoj, prandaj sa i përket këtyre çështjeve, unë jam për që të miratohet buxheti sepse janë shumë projekte të planifikuara. Edhe kur janë miratuar buxhetet në sipas afateve në muajin shtator ne kemi pasur suficit buxhetor, madje vetëm këto 4 vitet e fundit nëse nuk gaboj kanë qenë rreth 6 - 7 milion euro suficit, pra unë jam që të vazhdohet me këtë projektbuxhet, mirëpo edhe për projektet kur të vendosen kontrollat të jenë më efikase, shembull projekti ura në fshatin Gllamnik është dështim total që 7 muaj ka filluar, andaj kërkoj t'iu jepet më shumë prioritet, përndryshe unë e mbështesë me qëllimin më të mirë që të ecin përpara projektet zhvillimore dhe që mos ketë suficit në qeverisje.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së e mbështesim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të projekt buxhetit të Komunës për vitin 2021 dhe prioritetet për vitet 2022/2024.

z. Fatlum Osmani, U.D drejtor i DBF-së, theksoi, sa për sqarim, e thash se ky buxhet është më i mirë se buxheti i vitit 2021 i cili është miratuar në vitin 2020, sepse këtu ka ndryshime shumë të vogla.

z. Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim që propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023 dhe 2024, t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Me 6 vota PËR, 3 vota KUNDËR dhe asnjë votë të PËRMBAJTURA, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të propozim vendimit për projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023-2024, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2. Ngritja e Grupit punues për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022

z. Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, sipas kësaj pike të rendit të ditës kemi për obligim të formojmë një Grup punues i cili do ta bëjë draftin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2022 kështu që mendoj se në këtë Grup punues të jenë të përfshira përmes anëtarëve të tyre të gjitha partitë politike të përfaqësuara në këtë Kuvend, Besoj që siç është praktikë e këtij Kuvendi nuk ka ndonjë shkelje.

z. Naim Çunaku, theksoi, komisionet që i ngritë Kuvendi, dhe në këtë rast jemi duke biseduar për planin e punës së Kuvendit, vendimi ynë është meritore dhe nuk kemi kundërshtime sepse është marrëveshje e jona se çfarë plani duam ta bëjmë.

z. Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, atëherë më mirë është që këtë pikë ta miratojmë, respektivisht t'i rekomandojmë Kuvendit për ngritjen e Grupit punues, mirëpo në mbledhjen e Kuvendit

të jepen propozimet e anëtarëve në përbërjen e Grupit punues, andaj a ka ndokush që dëshiron fjalën lidhur me këtë çështje, përveç asaj që Grupi i LVV-së propozoi që sot në këtë mbledhje të KPF-së të jepen emrat kurse në mbledhjen e Kuvendit vetëm i miratojmë nëse veç nuk ka ndonjë propozim tjetër. **z.Naim Çunaku**, theksoi, ne sot mund t'i bëjmë një propozim Kuvendit se sa anëtarë të jenë në Grupin punues i cili do ta përgatit draftin e planit të punës së Kuvendit, gjë për të cilën po besoj se të gjitha subjektet e përkrahën, dhe për anëtarët e Grupit punues, emrat e të cilëve do të jepen sot apo nesër. **z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit**, theksoi, propozimi im ishte që çdo subjekt politik që është i përfaqësuar në Kuvend ta ketë përfaqësuesin e tyre në Grupin punues përkatës, mirëpo për këtë kërkoj nëse është e mundur të na tregoj për praktikën e kaluar edhe zyrtari për punë të Kuvendit.

Nga zyra Ligjore, tregohet praktika e kaluar lidhur me këtë çështje, ndër të tjera theksohet se në të kaluarën ka qenë praktikë që Grupi përkatës punues është përbërë prej 7 anëtarëve ku 5 kanë qenë nga gjitha Grupet e këshilltarëve të subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend, dhe 2 anëtar nga radhët e Ekzekutivit të Komunës për arsye të përfshirjes në planin e punës së Kuvendit të disa çështjeve / temave që janë të parapara me ligje dhe akte tjera nënligjore të trajtohen në Kuvendin e Komunës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, pra besoj se jemi në rregull sa i përket kësaj çështje dhe nëse nuk keni diçka rreth kësaj unë propozoj që grupi punues sipas kësaj pike të rendit të ditës të përbëhet prej 7 anëtarëve, 5 prej të cilëve të jenë nga radhët e të gjitha subjekteve politike të Kuvendit dhe 2 anëtar nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, ndërsa emrat e anëtarëve të propozohen në mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet nesër, a pajtoheni me këtë.

Njëzëri me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit për ngritjen e Grupit Punues për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, me strukturën e mbështetur nga anëtarët e Komitetit, dhe atë, që Grupi punues të përbëhet prej 7 anëtarëve, prej tyre 5 anëtar nga radhët e Kuvendit (nga 1 prej secilit subjekt politik të përfaqësuar në Kuvend) dhe 2 anëtar nga Ekzekutivi i Komunës.

Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0002927/22

Podujevë,

13 janar 2022

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Hilmi Hoxha